


01-1383



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-136376/20 dt. 10.08.2020, të pronareve Gjyla Gashi nga Mramori, dhe investitorit “N.N. R&Rukolli” sh.p.k., me seli në Skenderaj, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesave “A” dhe “B”, me etazhitet B+P+5, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “A6”, të tërsisë urbane “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Ndue Përllëshi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 18.08.2021, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** Gjyla Gashi nga Mramori, dhe investitorit “N.N. R&Rukolli” sh.p.k., me seli në Skenderaj, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-136376/20 dt. 10.08.2020, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesave “A” dhe “B”, me etazhitet B+P+5, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-252808 dt. 27.02.2017, në parcelën kadastrale nr. 658-2 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-00658-2, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik “A6”, të tërsisë urbane “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Ndue Përllëshi” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 119, 121, 123, 125, 127, 129, 131, 133, 135, 137, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Pronareve Gjyla Gashi nga Mramori, me investitor “N.N. R&Rukolli” sh.p.k., me seli në Skenderaj, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-136376/20 dt. 10.08.2020, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, përkatësisht ndërtesave “A” dhe “B”, me etazhitet B+P+5, e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “A6”, të tërsisë urbane “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 658-2, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-252808 dt. 27.02.2017, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/01-64254/20 dt. 12.01.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Halim Hoti; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Ragip Behrami; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Alban Xhema; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Altin Istogu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Naim Hoti; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Burim Halilaj me nr. të licensës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-136376/20 DT. 18.08.2021**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
*B. Vllasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Mimoza Berisha Prestreshi

*Mimoza Berisha Prestreshi*

Faqe 2 prej 3



Drejtori,  
*Arbata Vlluri*